

Emri i Lëndës : Teoritë e Komunikimit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 102	A	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Erlis Çela, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Kjo lëndë i ofron studentëve një vështirim të zgjeruar mbi teoritë e komunikimit. Lënda e teorive të komunikimit shqyrton perspektiva teorike kryesore mbi proceset e komunikimit. Përmes një qasje të integruar teorive kryesore në hulumtimin e traditave kryesore të teorive të komunikimit, studentët njihen me përjasjet objektive dhe interpretuese ndaj komunikimit. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të njihen me shtatë traditat në fushën e teorive të komunikimit. Lënda është konceptuar në mënyrë që tu japë mundësi studentëve të klasifikojnë teoritë e ndryshme të komunikimit dhe të dallojnë pikat e përbashkëta të këtyre teorive.					
Objektivat							
Konceptet Kryesore		Traditë teorike Shkollat e komunikimit Semoptika Masmedia Efektet e medias Ekologjia e medias Qasje objektive Qasje interpretuese Komunikim ndërpersonal Komunikim në grup Retorikë					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Të flasësh për teorinë-Çfarë është teoria? Përkufizimi i përgjithshëm i teorisë dhe pse duhet të studiojmë teoritë. Metaforat për të shpjeguar teoritë dhe imazhi i teorive. Teoritë si rrjeta, lente dhe harta. Dy përjasjet kryesore në klasifikimin e teorive. Përjasja objektive dhe përjasja i interpretuese. Klasifikimi i teorive të komunikimit. Dallimi mes shkencëtarëve bihevizistë dhe retoricienëve. Prezantimi i literaturës dhe burimeve bazë të lëndës, prezantimi i syllabus dhe mënyrës së vlerësimit. Fq 13-23, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016						
2	Vlerësimi i teorive. Cilat janë kriteret që duhet të përmbushë një teori e mirë. Standardet shkencore për teoritë objektive dhe teoritë interpretuese. Hartëzimi i territorit. Shtatë tradita në fushën e teorive të komunikimit. Përjasja e Robert Craig mbi shtatë traditat. Përcaktimi i kufijve në fushën e teorive të komunikimit. Fq 37-50, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016						
3	Komunikimi ndërpersonal. Metafora e lojës dhe komunikimi ndërpersonal. Modeli i bulingut si mënyrë për të përcjellë mesazhet, është pikëpamja më e përhapur rreth komunikimit. Komuniteti: Efekti social i pritshmërive të të tjerëve. Ndërveprimi Simbolik. Menaxhimi i koordinuar i kuptimit. Fq 51-64, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016						
4	Teoria e depërtimit social.Çfarë është depërtimi social dhe si zhvillohet procesi i depërtimit social. Struktura e personaliteti sipas Irwin Altman dhe Dalmas Taylor. Teoria e përpunimit të informacionit social. Ndryshimet teknologjike dhe ndikimi në marrëdhëniet ndërpersonale. Ndryshimet e shpejta të teknologjisë së komunikimit i kanë vënë në vështirësi studiuesit e komunikimit që përpiqen të kuptojnë se çfarë ndikimi kanë ato për marrëdhëniet ndërpersonale. Fq 96-107, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016						

5	Teoria e shkeljeve të pritshmërisë. Modeli i komunikimit sipas parimit të hapësirës personale. Koncepti i hapësirës personale si vëllimi i padukshëm dhe i ndryshueshëm i hapësirës, e cila rrethon një individ, duke përcaktuar distancën që preferon të ketë me të tjerët. Proksemika dhe njohja me studimin e hapësirës sipas Edward Hall. Njohja me konceptet bazë të teorisë sipas autores Judee Burgoon. Teoria e përpunimit të informacionit social dhe idetë e autorit Joseph Walther. Koncepti i Komunikimit të ndërmjetësuar nga kompjuteri. Komunikimi i ndërmjetësuar nga kompjuteri dhe komunikimi ballë për ballë. Fq 177-212, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
6	Komunikimi Publik dhe në grup Konceptet kryesore të teorive që studiojnë komunikimin publik dhe komunikimin në grup. Një vështrim i përgjithshëm mbi komunikimin organizativ. Përfaqsa kulturore ndaj organizatave. Teoria kritike e komunikimit në organizata. Fq 242-277, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
7	Retorika- Paradigma narrative. Idetë për ligjërimin ideal të Platonit dhe retorika e arsitotelit. Njohja me dallimet mes dialektikës dhe retorikës. Provat retorike, logos, etos dhe patos. Rregullat e retorikës: Parimet e artit të bindjes, të caktuara nga retoristët e lashtë- krijimi, strukturimi, stili, interpretimi dhe kujtesa. Fq 278-308, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
8	Provim Gjysmëfinal
9	Komunikimi masiv. Ekologjia e mediave. Njohja me idetë e teoricienit Marshall McLuhan. Marrëdhënia e medias me kulturën dhe njohja me qasjet postmoderniste. Baza e torisë së McLuhan sygjeron që mediat duhet kuptuar ekologjikisht. Analizimi i konceptit "Mediumi është mesazhi". Fuqia e një medium për të na shndërruar. Duke e përdorur vazhdimisht një medium ai bëhet një lloj zgjatimi i vetvetes. Shtjellimi i konceptit të "fshtatit global". Roli medias në formësimin e fshatit global. Fq 309-322, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
10	Teoria e kultivimit si një portë hyrëse në fushën e studimit të efekteve të mediave. Prezantimi i konceptet dhe parimeve bazë të teorisë së kultivimit. Analizimi i qëndrimeve të Geroge Gerbner dhe Marshall McLuhan mbi fuqinë dhe ndikimin e mediave. Ndryshe nga McLuhan që e mbivendoste mediumin me mesazhin, Gerbner besonte se fuqia e TV buron nga përmbajtja simbolike e dramës së jetës së vërtetë, e shfaqur orë pas ore, ditë pas dite. Gerbner besonte se televizioni dominon mjedisin e simboleve, duke u bërë rrëfimtar i pjesës më të madhe të historive. Njohja me kritikën mbi teorinë e kultivimit dhe diskutim mbi të metat e kësaj teorie. Fq 360-370, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
11	Teoria përdorim dhe kënaqësi. Kontributi i teorisë në studimin e efekteve të medias. Njohja me konceptin e komunikimit me dy ndalesa. Analizimi i kontributit të Elhu Katz në ndryshimin e këndvështrimit mbi studimet e efekteve të medias. Si e ndryshoi fushën e studimeve të efekteve mediatike zëvendësimi i pyetjes "Çfarë u bën media njerëzve?" me pyetjen "Çfarë bëjnë njerëzit me median?". Duke kuptuar nevojat e konsumatorëve të medias, qartësohen dhe arsyet se pse ne e përdorim median. Po ashtu sqarohen dhe efektet e medias ose mungesa e tyre. Tipologjia e Alan Rubin për përdorimin e medias. Fq 350-359, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
12	Teoria e përcaktimi të axhendës. Çfarë është përcaktimi i axhendës dhe si media ndikon në përcaktimin e axhendës së publikut? Shtjellimi i hipotezës kresore të përcaktimit të axhendës, sipas të cilës masmediat kanë aftësinë të transferojnë interesin për çështjet, nga axhenda e tyre informative tek axhenda e pulikut. Njohja me idetë e McCombs dhe Shaw mbi rolin e funksionit axhendë-përcaktues të mediave si përgjegjës për korrelacionin që ekziston ndërmjet mediave dhe dhe përparësive të publikut. Diskutimi mbi qendrueshmërinë e teorisë në kushtet e një ekosistemi mediatik të ndryshuar. A kanë të njëjtën fuqi në përcaktimin e axhendës, mediat e reja? Fq 371-385, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
13	Teoritë kritikë të komunikimit dhe Shkolla e Frankfurtit. Çfarë janë teoritë kritike të komunikimit dhe si mund të aplikohen parimet kryesore në studimin e mediave të reja? Një vështrim mbi idetë e Georg Lukács, Theodor W. Adorno, Herbert Marcuse, etj. Media sociale, puna dixhitale përmes lentes së teorive kritike. Shtjellimi i konceptit të medias sociale dhe pushtetit sipas Christian Fuchs. Fq 389-401, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016

14	Linja të përbashkëta në teoritë e komunikimit. Dallimet dhe pikat e përbashkëta të shkollave kryesore të torive të komunikimit. Fq 467-482, Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
15	Prezantim projektsh
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016
Referenca të tjera	• Ollivier, Bruno: Shkencat e komunikimit, teori dhe arritje, Papirus, Tiranë 2015 • Eric Maigret, (2010) - Sociologjia e komunikimit dhe e mediave, Tiranë: Papirus • Jean-Pierre Meunier, Daniel Peraya, (2009) Hyrje në Teoritë e Komunikimit, Tiranë: Migreerallb • https://www.communicationtheory.org • http://www.communicationstudies.com/communication-theories
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të njohin teoritë kryesore të komunikimi
2	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi evoluimin e teorive të komunikimit në kohë dhe konceptet e reja të komunikimit
3	Studentët do të përfitojnë njohuri të nevojshme për të klasifikuar, analizuar dhe vlerësuar dobishmërinë e teorive të komunikimit.
4	Studentët do të jenë në gjendje të aplikojnë njohuritë e marra rreth teorive të komunikimit në projekte dhe studime kërkimore

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			128
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.12
ECTS			5.00